



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 392/prot.
13

Tiranë, më 28.09. 2018

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për periudhën janar - gusht 2018.

MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE POLITIKAVE BUXHETORE

(Blv. Dëshmorët e Kombit, nr. 3 Tiranë)

Sipas përcaktimeve në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" neni 19, institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve zbatojnë në mënyrë të pavarur buxhetin e tyre të miratuar nga Kuvendi. Në kuadër të pavarësisë në menaxhimin e buxhetit por edhe në respekt të transparencës së përdorimit të fondeve buxhetore, bazuar në ligjin nr.109/2017 "Për Buxhetin e vitit 2018", Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore", në vijim ju paraqesim një analizë të përdorimit të fondeve buxhetore për 8-mujorin e vitit 2018. Për vitin 2018 situata buxhetore për institucionin e Komisionerëve Publikë paraqitet si më poshtë.

Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor i rishikuar	Realizimi Fakti 8 mujor/progresiv	Realizimi në %
Shpenzime Korente	58,200	46,200	19,559	42.3%
Shpenzime Kapitale	9,000	9,000	86	1%
TOTALI	67,200	55,200	19,645	35.6%

Nga analiza e fondeve në momentin e detajimit sipas zërave të buxhetit të miratuar në fillim të vitit 2018, u vlerësua pamjaftueshmëria e fondeve në shpenzimet për mallra dhe shërbime. Për këtë arsye ky buxhet u rishikua me miratimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke bërë rialokimin e fondeve. Në vijim me aktin normativ nr.1 datë 26.7.2018 u bë pakësimi i

fondeve buxhetore për shpenzime personeli, fakt ky që është kundërshtuar dhe argumentuar nga Komisionerët Publikë, si cënim i pavarsisë së institucionit dhe në kundërshtim me ligjin nr.84/2016.

Lidhur me performancën e realizimit në nivelin 35.6 % të buxhetit faktik të vitit 2018, ju bëjme me dije se mosrealizimi i treguesve buxhetore ka ardhur si rezultat i:

1. Mosplotësimi të të gjithë strukturave organike deri në muajin qershor 2018, për arsye objektive të funksionimit të institucionit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me vendimin nr. 1/2018 datë 12.3.2018, ka vendosur shkarkimin nga detyra të ish Komisionerit Publik H.S., dhe një nga shkaqet e shkarkimit kishte të bënte me bllokimin e aktivitetit të institucionit.
2. Faktit që deri në qershor të vitit 2018, institucioni ka ushtruar aktivitetin pranë zyrave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe është asistuar prej tij me furnizimin e të gjithë bazës materiale të nevojshme. Në këto kushte gjatë kësaj periudhe, nuk është kryer asnjë shpenzim në këtë drejtim nga fondet buxhetore të miratuara në shpenzime operative. Gjithashtu nuk ka kryer pagesa për energji elektrike, ujë, shërbime postare etj.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, në fillim të muajit qershor është akomoduar në katin e dytë të ish-godinës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila është rikonstruktuar nga Ministria e Drejtësisë. Me plotësimin e stafit të nevojshëm administrativ nëpërmjet procedurave ligjore të rekrutimit, u rritën shpenzimet e personelit si dhe nisën të zhvillohen procedurat e parashikuara të prokurimeve në mallra e shërbime, duke plotësuar nevojat emergjente të institucionit në letër, kanceleri, shtypshkrime, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrave etj. Në vijim do të vlerësohen nevojat e shtuara të stafit, shpenzimet për energji, ujë, mirëmbajtje etj, në mënyrë që funksionimi i institucionit të vijojë normalisht. Po kështu theksojmë që janë finalizuar procedurat e prokurimit për pajisje mobilje, pajisje elektronike etj, sipas kërkesave të argumentuara pas vendosjes në ambientet e reja, si dhe është bërë lëvrimi në kohë i tyre.

- Shpenzimet korente dhe kapitale, për periudhën janar-gusht 2018 paraqiten si më poshtë

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2018, i cili përfshin shpenzimet korente dhe shpenzimet kapitale, është 67,200 mijë lekë, buxhet i cili u rishikua me aktin normativ duke u pakësuar me 12,000 mijë lekë në zërin “shpenzime personeli”. Në total ky buxhet për vitin 2018 arriti në

vlerën 55,200 mijë lekë. Realizimi i shpenzimeve për periudhën 8 – mujore të vitit 2018 është 19,645 mijë lekë ose 35.6% e buxhetit total.

Në mënyrë analitike, performanca e realizimit të shpenzimeve për këtë periudhë, për institucionin e Komisionerëve Publikë paraqitet në vijim.

000/lekë						
Artikulli	Emërtimi	Buxheti vjetor	Buxheti vjetor Plan i rishikuar	Buxheti Plan 8 mujor	Realizimi Fakti 8 mujor/progresiv	Realizimi në %
600+601	Paga dhe sigurime	54,200	39,700	36,000	18,228	46%
602	Shpenzime për mallra dhe shërbime	4,000	6,500	5,300	1,331	20%
231	Shpenzime kapitale	9,000	9,000	9,000	86	1%
	TOTALI	67,200	55,200	50,300	19,645	35.6%

Sipas artikujve analiza paraqitet si më poshtë:

1. Artikulli 600 dhe 601, shpenzime personeli, buxheti vjetor i alokuar është 54,200 mijë lekë dhe buxheti i rishikuar është 39,700 mijë lekë . Për 8-mujorin, realizimi faktik i shpenzimeve të personelit është 18,228 mijë lekë ose 46% e fondit të rishikuar. Gjatë këtij 8-mujori, nuk është përdorur i plotë fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore sipas detajimit në fillim të vitit, për shkak të mosplotësimit të strukturave organike deri në muajin qershor. Fondi i pagave i pakësuar me aktin normativ nr.1 datë 26.7.2018 do të përdorej për shtesat që u takojnë me ligj këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë. Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2018 është **26 vetë**, dhe numri faktik në këtë periudhë është **23 vetë**. Lidhur me fondin e pagave ju bëjmë me dije se komisioni i ligjeve të Kuvendit në mbledhjen e datës 25.9.2018 ka miratuar një pjesë të kërkesave tona për shtimin e numrit të punonjësve dhe riklasifikimit të pagave. Miratimi i strukturave shtesë dhe riklasifikimi i pagave sipas kërkesës që i është bërë Kuvendit të Shqipërisë ka një efekt financiar si më poshtë;

a) Rritje e numrit të stafit të këshilltarëve me 4 vetë, ka një efekt mujor financiar shtesë prej **960 mijë lekë** ose **11,520 mijë lekë** në vit, vlerë e cila përbën **21,2 %** të buxhetit të miratuar në fillim të vitit për paga dhe sigurime.

000 lekë

	Nr.aktual i punonjësve	Nr.shtesë i kërkuar	Klasifikimi i pagës	Efekti mujor shtesë ne pagë	Efekti vjetor shtesë ne pagë
Keshilltarë ligjorë	4	2	80% G3	480	5,760
Keshilltarë ekonomikë	2	2	80% G3	480	5,760
Totali	6	4		960	11,520

- b) Riklasifikimi i pagave të njësisë së personelit administrativ ka një efekt mujor financiar shtesë prej **129 mijë lekë** ose rreth **1,210 mijë lekë** në vit, vlerë e cila përbën **2,2 %** të buxhetit të miratuar në fillim të vitit për paga dhe sigurime.

000 lekë

	Sruktura aktuale	Klasifikimi aktual i pagave	Riklasifikimi i propozuar i pagave	Efekti mujor shtesë ne pagë	Efekti vjetor shtesë ne pagë
Kancelar	1	I-b	I-a E barasvlefshme me Sekretarin e Përgjithshëm në KPK dhe KPA, dhe Kancelarin e Gjykatës së Lartë	13	150
Specialist Sekretarie	2	IV-a	III-b	30	360
Specialist Protokoll/ Arkiv	1	IV-b	IV-a	14	170
Specialist Redaktor gjuhësor	1	IV-b	IV-a	14	170
Specialist Pritje me popullin	1	IV-b	IV-a	14	170
Shofer	1	V	VI	16	190
Totali				129	1,210

2. **Artikulli 602 “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”**. Buxheti i miratuar në fillim të vitit në këtë artikull për vitin 2018 është 4,000 mijë lekë dhe pas rialokimit të fondeve me kërkesën e institucionit, nëpërmjet transferimit nga fondi i pagave, ky buxhet arriti në vlerën 6,500 mijë lekë. Për 8 - mujorin shpenzimet faktike për mallra dhe shërbime janë 1,331 mijë lekë ose 20% e buxhetit vjetor të rishikuar. Ky nivel i realizimit të fondeve është

arritur në 4 mujorin e dytë të vitit pas plotësimit të strukturës organike dhe akomodimit në ambientet e reja të punës. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar procedurat e prokurimit për mallra dhe shërbime kryesisht sipas kategorive si më poshtë:

Nr.	Emertimi	000 lekë	
		602	
		Plan	Fakt
1	Shpenzime udhëtime, dieta	259	-
2	Materiale e shpenzime zyre	3,942	853
3	Shërbime	1,554	470
4	Shpenzime transporti	460	-
5	Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme	150	6
6	Shpenzime te tjera speciale	135	2
	TOTALI	6,500	1,331

Duke analizuar realizimin faktik të fondeve, vëmë në dukje se janë realizuar procedurat e prokurimit për materiale zyre si letër, kanceleri, materiale pastrimi si dhe jemi duke zhvilluar procedurën e prokurimit të tonerave që zë pjesën më të madhe të fondit të planifikuar në këtë zë. Gjithashtu, vetëm në dy muaj janë shpenzuar 470 mijë lekë për shërbime të ndryshme që lidhen me akomodimin në godinën e re si energji, shpenzime postare, telefon etj. Mendojmë që deri në fund të vitit, me këto ritme ky fond do të realizohet plotësisht. Për sa i përket shpenzimeve të transportit, theksojmë se meqënëse jemi në proces për blerjen e automjetit, këto shpenzime do të jenë kryesisht për karburant për automjet si dhe për gjenerator. Në përfundim, dëshirojmë të theksojmë se deri në fund të vitit, fondi prej 6,500 mijë lekë i vënë në dispozicion do të realizohet 100 %, realizim ky që arrihet në një periudhë 7 mujore të ushtrimit të aktivitetit të institucionit pasi sikurse ju shpjeguar më lart, në fillim të vitit nevojat tona janë plotësuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Kjo gjë justifikon kërkesën tonë të argumentuar për rritje të fondeve në shpenzime operative për vitin 2019. Synimi ynë është që nëpërmjet menaxhimit me efciencë të fondeve dhe në përputhje me dispozitat ligjore, të krijojmë kushtet optimale për aktivitetin e institucionit.

3. **Artikulli 231 "Shpenzime kapitale"** Buxheti i miratuar për vitin 2018, është **9,000 mijë lekë**. Realizimi faktik i shpenzimeve në investime për 8-mujorin e vitit 2018 është **86 mijë**

lekë ose 1% e buxhetit të miratuar në këtë zë, nivel ky i ulët për shkaqe objektive të përmendura më lart. Ky realizim do të përmirësohet ndjeshëm në periudhën në vazhdim sepse një pjesë e procedurave për pajisje zyre janë finalizuar dhe janë në proces likuidimi. Gjithashtu është në vijim procedura e blerjes së një automjeti për nevojat e institucionit. Fondi i investimeve i miratuar për vitin 2018, do të përdoret nga institucioni në vazhdim të veprimtarisë së tij, sipas detajimit të projekteve të miratuara dhe Regjistrin të Parashikimit të Prokurimeve.

Megjithëse realizimi faktik i investimeve për 8 mujorin është i ulët, theksojmë se situata e realizimit të fondeve në këtë zë, për arsye se disa procedura janë zhvilluar në muajin gusht paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Investimet	Plani	Realizimi	Koha e zhvillimit të procedurës	Muaji likuidimit
Blerje pajisje elektronike	960	311	gusht	shtator
Blerje pajisje dhe mobilje zyre	3,040	795	qershor, gusht	qershor,shtator
Software menaxhimit çeshtjeve	2,200		në proces,tetor-nëntor	
Software aktiviteti financiar	300		në proces,tetor	
Blerje automjet	2,500		në proces, shtator-tetor	
TOTALI	9,000	1,106		

Bashkëlidhur gjeni tabelat shoqëruese të raportit të monitorimit për 8–mujorin e vitit 2018.

Duke ju falënderuar,

KOMISIONERËT PUBLIKË

Florian Ballhysa



Darjel Sina

Konceptoi: A.Kastrati
Miratoi: A.Çeli

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke



Emri i Grupit		Komisioneret Publike		Kodi i Grupit		63		
				Shpenzimet e Institucionit				
Programet		(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	(2) PBA Viti 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 8 mujore /progressiv	(6) Fakti i Periudhes/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
0001	Programi 03360	0.0	0	67,200.0	55,200.0	50,300.0	19,645.0	-30,655.0
Totali i Shpenzimeve te Institucionit		0.00	0	67,200.0	55,200.0	50,300.0	19,645.0	-30,655.0
Shpenzime nga te Ardhurat jashte limitit					-			
Totali		0.00	0.0	67,200.0	55,200.0	50,300.0	19,645.0	-30,655.0

Nepunesi Zbatues	Emri		Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizus	Emri	
	Firma	Data		Firma	Data
	Adelina Kastrioti			Alketa Geli	
		27.8.2018			27.9.2018

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit	Komisionerët Publikë	Kodi i Grupit	63				
Programi	Veprimtaria e Komisioneri Publik	Kodi i Programit	03360				
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2017	(2) PBA Viti 2018				
		(3) Buxheti Vjetor Plan Fillëstar viti korrent 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishtikuar Viti 2018				
		(5) Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 8 muajore /progressiv	(6) Fakti I Periudhës/progressiv				
			Diferenca (7)=(6)-(5)				
600	Paga	49,400.0	34,900.0	32,800.0	16,789.0	-16,011.0	
601	Sigurime Shoqërore	4,800.0	4,800.0	3,200.0	1,439.0	-1,761.0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,000.0	6,500.0	5,300.0	1,331.0	-3,969.0	
603	Subvencione					0.0	
604	Transferëta Korrente të Brendshme					0.0	
605	Transferëta Korrente të Huaja			0.0	0.0	0.0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ			0.0	0.0	0.0	
Nen -Totali	Shpenzime Korrente	0.0	0.0	56,200.0	46,200.0	41,300.0	-21,741.0
230	Kapitale të Patrupezuara			9,000.0	9,000.0	9,000.0	-8,914.0
231	Kapitale të Trupezuara	0	0.0	9,000.0	9,000.0	9,000.0	0.0
232	Transferëta Kapitale						
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	0.0	0.0	9,000.0	9,000.0	9,000.0	-8,914.0
230	Kapitale të Patrupezuara						0.0
231	Kapitale të Trupezuara						0.0
232	Transferëta Kapitale						0.0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	0.0	9,000.0	9,000.0	9,000.0	-8,914.0
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit							0.0
otall (korrente + kapitale + Shp nga te ardh. jashte limitit		0.0	0.0	67,200.0	55,200.0	50,300.0	-30,655.0

Nepunësi Zbatues	Emri	Adelina Kasrati	Kordinatori i GMS/Nepunësi Autorizus	Emri	Alketa Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2018		Data	27.9.2018

ANEXSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treqesave te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	Komisionet Publike	63
Programi	Vepimet e Konstronimit Publik	3340



Kodi	Emertimi i Treqesave te Performances/Produktit	Mjesta matese	Shpenzimet (sipas vitit 2017)	Kosto per Mjeste (sipas vitit 2017)	Sasia (sipas planit te vitit 2018)	Shpenzimet (sipas planit te vitit 2018)	Kosto per Mjeste (sipas planit te vitit 2018)	Sasia (sipas rishikimit te vitit 2018)	Shpenzimet e rishikimit te vitit 2018)	Kosto per Mjeste (sipas rishikimit te vitit 2018)	Sasia e rishikimit 4 mujorin e pare te vitit 2018	Shpenzimet mujorin e pare te vitit 2018	Kosto per Mjeste per mujorin e pare te vitit 2018	Luhatjet ne Koston per Mjeste			Komente
														V = IV - I	V = IV - II	V = IV - III	
Produkti A	Vepimet e shporet e Institutit nr. institucionesh	1	1	0	1	67.200	67.200	1	55.200	55.200	1	18.645	18.645	#DIV/0!	-7%	-54%	

Nepunesi Zshtues	Emri	Adelina Kasrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alketa Celi
	Firma	<i>[Signature]</i>		Firma	<i>[Signature]</i>
	Data	27.9.2018		Data	27.9.2018

[Signature]

ANEXSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"
 Përundera e Raportimit: 4 mujori pare 2018

Kodi i Programit	3360	Emergimi i programit:							Komente
Qelimi 1	Respektimi i Adateve ligjore dhe parimit te procesit te regullit dhe respektimi te drejtlave themelore te subjektit te rinvlersimit, gjate ushtrimit te kompetencave ligjore te ankimit ndaj vendimeve te KPK.	Vepriantaria e komisionerit Publik							
	* Objektivat e politikës*:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emergimi i Treguesit te Performances/Produktit	Niveli faktik i vitit 2017	Niveli i planifikuar ne vitin 2018	Niveli i rishikuar per 4 mujorin e pare te vitit 2018	Niveli faktik per 4 mujorin e pare te vitit 2018	% e realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	Objektivi 1"Instiucioni i Komisionereve Publike mbron interesin publik gjate kryerjes se procesit te rinvlersimit dhe udhëhiget nga parimi i paanesise dhe pavarësisë, procesit te regullit ligjor, transparencës dhe frymës e bashkepunimit ndërmjet dy komisionereve publike, Operacionit Nderkombetar te Monitorimit dhe Instiucioneve te tjera.								
	Ushtrimi i te drejtlës te Komisionereve Publike, per ankimit, ndaj vendimeve te KPK	A		1	1	1	1	100%	

Nepunesi Zbatues	Emri	Adelina Kasrati	Kordinatori i QMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alkeza Çeli
	Firma			Firma	
	Data	27.9.2018		Data	27.9.2018.

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti i Kontraktuar	Plani i buxheteve viti 2018	Realizimi nga fillimi i vitit 2018	Realizimi për periudhën e raportimit vijtor	Realizimi Progressiv nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M630002	Pajisje dhe mobilje zyre	3,040	2018	2018	86	3,040.0	86	86	86	Procedura per mobilje zyre eshte realizuar ne mujin gusht dhe likuiduar ne mujin shtator 2018
M630013	Pajisje elektronike	960.0				960.0				Jane realizuar procedura e prokurimit por jane ne fazen e likuidimit ne mujin shtator
M630021	Software menaxhimit geshjeve	2,200.0				2,200.0				Procedura e prokurimit do te realizohet ne tetor
M630022	Software aktiviteti financiar	300.0				300.0				Do te realizohet ne tetor
M630020	Autonjete per institucionin	2,500.0				2,500.0				Eshte ne proces prokurimit
TOTALI		9,000			86	9,000.0	86	86	86	-

Nepunesi Zbates	Emri	Adelina Kasrati	Kordinatori i GMS/Nepunesi Autorizues	Emri	Alveta Ceçi
	Firma			Firma	
	Data			Data	

(Signature)
27.9.2018

(Signature)
27.9.2018